



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

Komisioni për Çështje Normative

Raport

Janar - Qershor 2017

Përmbajtja

1. Komisioni për Çështje Normative	2
2. Aktivitetet e Komisionit për periudhën janar - qershor 2017.....	3
2.1. Aktivitetet e parapara për këtë periudhë	3
3. Aktet nënligjore të trajtuara	4
4. Aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli	5
5. Takimet	5
6. Aktivitetet nga Plani i Punës dhe Rezultatet.....	6

1. Komisioni për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative është themeluar me vendim të Këshillit Prokurorial Nr. 49/2016 në këtë përbërje:

1. Bahri Hyseni, Kryesues
2. Deshirë Jusaj, anëtare dhe
3. Besim Kelmendi, anëtar

Fushë veprimtaria e Komisionit për Çështje Normative është rregulluar me Rregulloren Nr. 08/2015 për Komisionin për Çështje Normative.

Në bazë të rregullores, Komisioni për Çështje Normative është përgjegjës që:

- Të shqyrtojë bazën juridike për aktet nënligjore dhe dokumentet tjera normative, para miratimit të tyre në Këshill, përkatësisht a janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet në fuqi dhe rregulloret ekzistuese të Këshillit;
- Të analizojë dhe vlerësojë përshtatshmërinë e akteve nënligjore ekzistuese për funksionimin e Këshillit dhe prokurorive;
- Të shqyrtojë dhe përgatisë rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe dokumenteve të tjera para se dërgohen në Këshill për miratim;
- Të shqyrtojë çështjet që lidhen me metodologjinë dhe me teknikën unike të hartimit të akteve nënligjore;
- Të mbikëqyrë zbatimin e akteve nënligjore;
- Të shqyrtojë çështjet e tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe çështjet të cilat me vendim të veçantë nga Këshilli, i barten këtij Komisioni;
- Të angazhojë ekspertë sipas nevojës, për çështje të caktuara në fushëveprimin e komisionit me miratimin e Këshillit;
- Të organizojë dëgjime publike për çështje të caktuara gjatë hartimit të akteve nënligjore;

Komisioni kontakton me komisionet e tjera të Këshillit për t'i harmonizuar dhe unifikuar procedurat e punës dhe organizimit të tyre.

Komisioni për Çështje Normative bazuar edhe në rregulloren e tij i bashkërendon veprimet e tij me përfaqësuesit ndërkombëtar që mbështesin punën e Këshillit dhe Komisionit në veçanti me Ambasadën Amerikane, EULEX, projektin e BE-së dhe UNDP.

2. Aktivitetet e Komisionit për periudhën janar - qershor 2017

Aktivitetet e Komisionit për Çështje Normative për periudhën janar - qershor të vitit 2017 kanë qenë të bazuara në Planin e Punës së Komisionit i cili ka rrjedhur nga Plani i Punës së Këshillit i miratuar në fillim të këtij vitit.

2.1. Aktivitetet e parapara për këtë periudhë

- Hartimi i raportit të punës;
- Rregullorja për Klasifikim dhe Deklasifikim të të dhënave në Prokurorin e Shtetit;
- Miratimi i rregullores për klasifikimin dhe qasjen në dokumente zyrtare;
- Hartimi i dokumentit konceptual për ndryshimet ligjore lidhur me zbatimin e projektit për menaxhimin elektronik të lëndëve;
- Plotësim ndryshimi i akteve nënligjore konform kërkesave për zbatimin e projektit për menaxhimin elektronik të lëndëve;
- Analizë për harmonizimin e akteve nënligjore të Këshillit dhe rekomandimet përkatëse;
- Udhëzim administrativ për përcaktimin e kohës së hyrjes në fuqi të akteve nënligjore të Këshillit;

Nga aktivitetet e parapara për këtë periudhë, Komisioni ka arritur t'i përmbushë që të gjitha, madje ka përmbushur aktivitete të cilat nuk kanë qenë të planifikuara gjatë periudhës janar - qershor 2017, siç është rasti me Rregulloren për Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe Rregulloren për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel, që kanë qenë të planifikuara për periudhën shtator - tetor 2017, mirëpo pasi që kanë qenë kritere nga Bashkimi Evropian, Komisioni ka arritur t'i hartojë e të cilat më pas janë miratuar nga Këshilli.

3. Aktet nënligjore të trajtuara

Gjatë periudhës raportuese Komisioni i ka trajtuar 8 akte nën ligjore si më poshtë:

1. Draft Rregullorja për Qasje në Dokumente Publike;
2. Plotësim Ndryshimet e Rregullores Nr.09/2015 për Zgjedhjen e Kryesuesit dhe zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
3. Plotësim Ndryshimi i Rregullores mbi rolin dhe Veprimtarinë e Bordit Drejtues të Projektit TIK/SMIL;
4. Draft Rregullorja për Komisionin për Administrimin e Prokurorive;
5. Draft Rregullorja për Klasifikimin e Dokumenteve dhe Qasja në Dokumentet e sistemit prokurorial të Kosovës;
6. Draft Rregullorja për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel;
7. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 përcaktimin e shpenzimeve të reprezentacioni;
8. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në Këshillin Prokurorial dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës;

4. Aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli

Nga 8 aktet nënligjore të cilat janë trajtuar nga Komisioni, Këshilli ka miratuar 7 prej tyre, dhe atë:

1. Rregullore Nr.01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.09/2015 për Zgjedhjen e Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
2. Rregullore Nr.02/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr.03/2016 mbi rolin dhe veprimtarinë e bordit drejtues të projektit TIK/SMIL;
3. Rregullore Nr.03/2017 për Komisionin për Administrimin e Prokurorive;
4. Rregullore Nr.04/2017 për Klasifikimin e Informacioneve të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës;
5. Rregullore Nr.05/2017 për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel;
6. Udhëzim Administrativ Nr. 01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 përcaktimin e shpenzimeve të reprezentacionit;
7. Udhëzim Administrativ Nr. 02/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016 për përdorimin e telefonave fiks dhe mobil në Këshillin Prokurorial dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës;

Është në fazën e diskutimit draft Rregullorja për Qasje në Dokumente Publike

5. Takimet

Gjatë kësaj periudhe Komisioni ka mbajtur 6 takime. Takimi i parë i Komisionit është mbajtur me datë 21 shkurt 2017. Në këto takime përveç anëtarëve të Komisionit kanë marrë pjesë përfaqësues nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin punën e Komisionit dhe të sistemit prokurorial në përgjithësi. Po ashtu, takimet e Komisionit janë mbështetur nga administrata.

Vlen të përmendet se Komisioni ka filluar një praktikë të takimeve të përbashkëta me komisionet e tjera të përhershme të Këshillit ku gjatë kësaj periudhe ka mbajtur dy takime të përbashkëta me Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel. Në këto takime pika të rendit të ditës kanë qenë Draft Rregullorja për Komisionin për Administrimin e Prokurorive dhe draft Rregullorja për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel.

Përveç takimeve të Komisionit, kryesuesi i Komisionit ka mbajtur takime të veçanta edhe me përfaqësues të organizatave të brendshme dhe të jashtme, ku janë diskutuar çështje nga fushë veprimtaria e Komisionit për Çështje Normative.

6. Aktivitetet nga Plani i Punës dhe Rezultatet

Më poshtë në formë tabelore janë ta paraqitur aktivitetet të cilat kanë të planifikuara në bazë të planit të punës së Komisionit dhe veprimet që janë ndërmarrë nga Komisioni për gjatë kësaj periudhe.

	Aktiviteti	Bartësi i aktivitetit	Muaji	Rezultati
1	Hartimi i raportit të punës	<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni • Sekretari 	Janar	Është hartuar raporti i punës së komisionit, i cili do të jetë pjesë e Raportit Vjetor të Këshillit për vitin 2016.
2	Rregullorja për Klasifikim dhe Deklasifikim të të dhënave në Prokurorin e Shtetit	<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni 	Shkurt	Është miratuar Rregullorja Nr.03/2017 Klasifikimin e Informacioneve në sistemit prokurorial të Kosovës
3	Miratimi i rregullores për klasifikimin dhe qasjen në dokumente zyrtare	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Zyra Ligjore • Komisioni 	Mars	Komisioni ka mbajtur takim në të cilin ka formuar grup punues për draftimin e kësaj rregullore
4	Hartimi i dokumentit konceptual për ndryshimet ligjore lidhur me zbatimin e projektit për menaxhimin elektronik të lëndëve	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Departamenti për TIK • Zyra Ligjore • Komisioni 	Prill	Është hartuar dokumenti konceptual ku janë identifikuar aktet nënligjore të cilat duhet të ndryshohen për zbatimin e projektit
5	Plotësim ndryshimi i akteve nënligjore konform kërkesave për zbatimin e projektit për menaxhimin elektronik të lëndëve	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Departamenti për TIK • Zyra Ligjore • Komisioni 	Prill	Është mbajtur takimi i 5 komisioneve të përhershme të Këshillit ku janë listuar aktet nënligjore të cilat do të rishikohen. Procesi i rishikimit do të fillojë në shtator.
6	Analizë për harmonizimin e akteve nënligjore të Këshillit dhe rekomandimet përkatëse	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Zyra Ligjore • Komisioni 	Maj	Është mbajtur takimi i përbashkët me të gjitha Komisionet e përhershme të Këshillit dhe janë identifikuar aktet që duhet të plotësohen dhe ndryshohen
7	Miratimi i rregullores për Komisionin për Administrimin e Prokurorive	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Zyra Ligjore • Komisioni 	Maj	Është miratuar Rregullorja Nr.04/2017 për Komisionin për Administrimin e Prokurorive
8	Miratimi i Rregullores për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel	<ul style="list-style-type: none"> • Divizioni për Buxhet dhe Financa 	Maj	Është miratuar Rregullorja Nr.05/2017 për Komisionin për Buxhet, Financa dhe Personel

		<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni 		
9	Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Komisioni 	Qershor	Është miratuar Udhëzim Administrativ Nr.01/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit
10	Ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Përdorimin e Telefonave Fiks dhe Mobil në Këshillin Prokurorial dhe Prokuroritë e Republikës së Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretariati • Komisioni 	Qershor	Është miratuar Udhëzim Administrativ Nr.02/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2016 për Përdorimin e Telefonave Fiks dhe Mobil në Këshillin Prokurorial dhe Prokuroritë e Republikës së Kosovës